



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 163/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren, paraqitur kundër subjekti politik Nisma për Kosovën dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterave në objekte publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 08.06.2014, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 05.06.2014, nga LVV-ja dega në Prizren me të cilën pretendohet se me datën 04.06.2014 rreth orës 15:00 në Prizren, në rrugën “Remzi Ademaj” aktivistët e subjektit Nisma për Kosovën kanë vendosur banerët e kandidatëve të tyre për deputet në muret e Kuvendit Komunal të Prizrenit. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur 1 fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës nuk vërehet dhe nuk shihet qartë se posterat e kandidatëve të subjektit politik Nisma për Kosovë janë të vendosura në muret e Kuvendit Komunal të Prizrenit, andaj një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante, prandaj PZAP-i, duke u bazuar nënin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

Anr.163/2014 më datën 08.06.2014

Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani



### **Udhëzim Juridik:**

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.